



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0495

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Triangle" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc" me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1, me 16/10/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Triangle" SH.P.K. me nr. 2023/0495 , e datës 17/07/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc" me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit ktheht në ri-vlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me datë 04.05.2023, Komuna e Gjakovës nga cilësia e saj si AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: "Renovimi dhe adaptimi Shkollës Zef Lush Marku-Brekoc", me numër të prokurimit 632-23-4357-5-2-1.

Me datën 23. 06. 2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës OE "Nbt- Ing" shpk.

Me datën 03.07.2023 në AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE “Triangle” Sh.P.K të cilën me vendim me datën 06. 07. 2023 AK e ka refuzuar.

Me datë 17.07.2023, OE Triangle” Sh.P.K ka ngritur ankesë në OSHP me numër 2023/0495 (numër protokolli).

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 27.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të anulohet vendimi i AK, lënda të rivlerësohet

Deklarimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit

Deklarimi i Ankuesit: Pajtohem me mendimin e ekspertit

Deklarimi i AK-se: Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Në këtë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

- procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;
- lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;
- vlera e parashikuar e kontratës: 399,969.82 € vlere e mesme, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.32 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

Pohimet ankimore të OE "Triangle"sh.p.k.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) OE ka ofruar se menaxheri i projektit Z. Ismet Berisha ne bazë te dëshmimeve te ofruara paguhet nga buxheti i Kosovës dhe ka pagë primare te rregullt me nga 40 orë në javë. OE ankues pretendnon se një arsyetim i tillë nuk qëndron, bazuar ne kërkesat e dosjes se tenderit dhe sqarimet e dërguara nga OE ankues tek AK-Komuna e Gjakovës me datën 12.06.2023 konstatojmë se AK-Komuna e Gjakovës nuk mund te paragjykoj ne këtë fazë nëse z. Ismet Berisha ne rolin e menaxherit te kontratës do te angazhohet apo jo ne këtë projekt me orar te plotë gjatë tërë kohës se ekzekutimit te kontratës. Është detyrë dhe përgjegjësi e AK-Komuna e Gjakovës qe gjatë ekzekutimit te kontratës te mbikëqyrë kontratën nëse është duke u ekzekutuar ne bazë te kushteve te përcaktuara ne dosje te tenderit. Po ashtu pas kërkesës për sqarime shtesë nga AK-Komuna e Gjakovës te datës 08.06.2023 , operatori ekonomik ka kthyer sqarimet me datën 12.06.2023 dhe konfirmon angazhimin e Z. Ismet Berisha nëse fitohet kontrata me orar prej 40 orë në javë. Eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës ka deklaruar se ne shkresat e lëndës, kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne sqarimet e lartcekura konstatojmë se ky pretendim ankimor është i bazuar. Paneli shqyrtues këtë pretendim e klasifikon si të bazuar për shkak se OE ankues lidhur me menaxherin e projektit, pas kërkesës së AK për sqarime shtesë ka ofruar deklaratë me shkrim,deklarata me shkrim është e nënshkruar edhe nga vet inxhinieri z.Ismet Berisha i cili do të angazhohet në projekt për 40 orë në javë nga ora 08:00-16:00 (sipas nevojës edhe më shumë) nëse fitohet projekti i lartëshënuar. Andaj, mbetet në përgjegjësi të AK që implementimin e kontratës ta bëjë konform rregulloreve dhe ligjeve në fuqi. AK, megjithatë në fazën e ri-vlerësimit konform nenit 52, paragrafi 7 të LPP, në rast të ndonjë dyshimi mund të kërkoj të konfirmohet drejtëpërdrejtë angazhimi i z. Ismet Berisha se cili do të jetë pozicioni i tij nëse fitohet kontrata nga OE apo zgjidhja që ai do ta zbatoj.

Ankuesi, po ashtu, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekoamanduar për kontratë nga AK, duke pretenduar se z. Tahir Sopa është dënuar nga gjykata përkatëse disa herë për vepra penale te falsifikimit dhe te mashtrimit ne prokurim P.nr 34/2019 te datës 29.06.2021. Këtë pretendim të OE ankues, me vendimin mbi kërkesën për ri-shqyrtim AK e ka hedhur poshtë duke ju ofruar dëshmi vërtetimin nga ana e gjykatës. Eksperti shqyrtues ka sqaruar në bazë te shënimeve momentale ne ARBK Z. Tahir Sopi nuk figuron ne rolin e përfaqësuesit te autorizuar dhe aksionarit mirëpo AK-Komuna e Gjakovës duhet të bëjë sqarimet nëse ne kohën e ofertimit dhe te njoftimit për kontratë Z. Tahir Sopa ka qenë i angazhuar ne rolin e përfaqësuesit te autorizuarit, aksionarit apo drejtuesit sipas kërkesave te paragrafit 5 te nenit 65 te LPP-së duke ofruar dëshmi se pronar aktual është z. Bexhet Baftjaraj. Paneli shqyrtues lidhur me këtë pretendim dhe sqarim më në detaj për të gjitha palët në procedurë, kërkoj interpretim prej Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, për mes emailit me dt. 26.09.2023, si në vijim:

"Në nenit 65 të LPP, paragrafi 3 citon: "Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;

Pyetja e panelit shqyrtues që kërkon interpretim është:

Një personi I cili ka qenë pronar I mëhershëm "I një biznesi" është dënuar me aktgjykim të formës së prerë denim me burg për vepren penale mashtrim në prokurim publik d.t.th. brenda 10 viteve ,

Tani këtij biznesi pjesëmarrës në këtë aktivitet të Prokurimit (pas ndryshimeve të bëra në regjistrin e ARBK), ky person nuk i figuron më në asnjë dokument të dorëzuar në ofertë (deklaratë nën betim, çertifikatë të regjistrimit, etj) se I njëjti mbanë ndonjë pozicion në kompani se është drejtues, menaxher apo drejtor I biznesit, andaj si I tillë ky OE, a duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurim publik konform nenit 65 të LPP, paragrafi 3 dhe nën paragrafet tjera të tij"

Konkretisht: Kjo dispozitë e nenit 65 të LPP, a vlenë vetëm për ndonjë pronar drejtues, menaxher ose drejtor i saj aktual apo edhe për ish ndonjë pronar drejtues, menaxher ose drejtor të saj.

Lidhur me këtë, paneli shqyrtues më dt. 04.10.2023, ka pranuar këtë interpretim nga KRPP:

"Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Pranueshmerinë e kandidatëve ose tenderuesve e parasheh neni 65 i LPP-së.

Paragrafi 3 i nenit 65 i LPP-ës, përcakton si në vijim:

"Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara" Pra, paragrafi 3 i nenit 65 fletë për drejtuesit, menaxherët ose drejtorët e kompanive të cilët janë **aktualisht** pjesë e stafit menaxherial të kompanisë dhe nuk flet për ish stafin menaxherial të kompanisë.

Për me shumë, një sqarim të kësaj dispozite, **KRPP me datën 22.11.2022, ka publikuar një OPINION në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik, përkatësisht në Linkun: "Informacione" tek "Pyetjet e shpeshta", Pyetja me numër 1, andaj lidhur me çështjen në fjalë, KRPP iu këshillon t'i referoheni Opinionit në pyetjen me Nr.1."**

Duke ju referuar këtij interpretimi të KRPP, neni 65 paragrafi 3 i LPP fletë për drejtuesit, menaxherët ose drejtorët e kompanive të cilët janë **aktualisht** pjesë e stafit menaxherial të kompanisë dhe nuk flet për ish stafin menaxherial të kompanisë, megjithatë udhëzohet AK që për çështjen në fjalë duhet me ju referu opinionit nr. 1 të KRPP, i cili në pjesën e fundit, citat: "Në çdo rast, duke mos pas ndonjë dispozitë të veçantë në LPP që sanksionon sjelljet e tilla **de facto**, është në diskrecion të autoritetit kontraktues në fjalë që të dëshmoj sjelljen abuzive të Operatorit Ekonomik duke prodhuar dëshmitë adekuate."

Ankuesi, po ashtu, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekoamanduar për kontratë nga AK, duke pretenduar se nuk ka plotësuar shumen e kërkuar të referencave sepse sipas OE ankues disa nga lista e referencave nuk janë punë të ngjashme (shih listën sipas ankesës). Lidhur me këtë ekspertit shqyrtues ka konstatuar se ky pretendim ankimor është i pa bazuar sepse edhe listat e prezantuara kanë të bëjnë me renovime dhe rikonstruime të natyrave të punës. Paneli shqyrtues e mbështet ekspertin shqyrtues se ky pretendim është i pa bazuar për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar mjaftueshëm kontrata të realizuara konform kërkesës së Dosjes së Tenderit si dhe me sqarim AK ka lejuar si të pranueshme edhe punët e ndërtimeve të ulëta.

Ankuesi, po ashtu, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekoamanduar për kontratë nga AK, duke aluduar se nuk e plotësojnë përvojën për: z. Bexhet Baftjaraj, z. Nexhat Bytyqi, z. Kujtim Suka, z. Gafurr Dakaj. Lidhur me këtë ekspertit shqyrtues profesional ka konstatuar se e ky pretendim ankimor që ka të bëjë me përvojën e punës për këta 4 inxhinier të angazhuar përfshirë edhe menaxherin e projektit është i pa bazuar sepse AK-Komuna e Gjakovës ka specifikuar tek kërkesa saktë se përvoja duhet të jetë 5 vjeçare e stafit të angazhuar ndërsa tek dëshmitë nuk ka specifikuar saktë me çka duhet të dëshmohet përvoja e punës. Te gjithë këta punëtor në CV-it e tyre shkruan se kanë përvojë mbi 5 vite, mirëpo është përgjegjësi e AK-Komuna e Gjakovës që të kërkojë dëshmi të caktuara përkatëse në rast të tillë në mënyrë që të dëshmohet saktë përvoja e punës dhe duke u bazuar në sqarimet e lartcekura konstatojmë se ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Paneli shqyrtues e mbështet ekspertin shqyrtues se ky pretendim është i pa bazuar, për faktin se të gjithë të lartpërmendurit kanë mbi 15 vitet prej kohës së diplomimit dhe kanë marrë titullin inxhinier dhe për të cilët në DT nuk është kërkuar përvojë me natyrë specifike por vetëm përvojë pas diplomimit.

Ankuesi, po ashtu, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekoamanduar për kontratë nga AK, duke pretenduar rreth çmimeve Jo Normalisht të ulëta theksojmë se AK-Komuna e Gjakovës me datë 13.06.2023 ka kërkuar nga OE NBT ING sqarimin e disa pozicioneve, ku po me të njëjtën datë OE NBT ING ka kthyer përgjigjen ku thekson se kemi disa çmime me të ulëta dhe mbulohen me pozicionet e çmimeve të larta. AK-Komuna e Gjakovës duhet të veprojë në harmoni me nenin 41.8 të Rregullores 01/2022. Lidhur me këtë ekspertit shqyrtues këtë pretendim e ka klasifikuar si pjesërisht të bazuar, ngase Duke pasur për bazë që edhe vetë OE NBT ING ka pranuar se kemi të bëjmë me disa çmime me të larta e disa mbi çmimet e furnizimit rekomandojmë AK-Komuna e Gjakovës që të bëjë sqarime shtesë në këtë pikë sipas nenit 41.8 të Rregullores 01/2022 për prokurim publik. Sqarimi i dhënë nga NBT ING

Duke u bazuar në kërkesë tuajën ne po ju sqarojmë se vet fakti se ne disa pozicione ka çmime me të larta e ne disa mbi çmimet e furnizimit dhe montimit rezulton që pozicionet e mbulojnë njera tjetrën dhe kjo është bërë me të vetmen arsye se nga stafi ynë gjatë analizimit të projektit është bërë analiza e planit dinamikë se si të organizohen punët në terren duke pasqyruar rrjedhën e realizimit të projektit.

Paneli shqyrtues, e mbështet këtë arsyetim të ekspertit shqyrtues dhe konform rekomandimit të dhënë.

Prandaj duke ju referuar nenin 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Prandaj, Paneli shqyrtues në bazë të shpjegimeve të ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe duke u bazuar në

dizpozita ligjore, se AK duhet ta ketë parasysh se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 59 të LPP, i cili në paragrafin 4, citon: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*", si dhe konform nenit 56 të LPP, i cili në paragrafin 3, citon: "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*" e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - "TRIANGLE" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: